



Njoftim Shtypi Nr. 08/231
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME
2 Tetor 2008

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Uashington, D.C. 20431 SHBA

Deklaratë nga Përfaqësuesja e Përhershme e FMN-së në Shqipëri

Përfaqësuesja e Përhershme e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Shqipëri, Ann-Margret Westin, bëri deklaratën e mëposhtme në Tiranë me 26 Shtator:

“Programi aktual 3-vjeçar i FMN-së me qeverinë e Shqipërisë, i mbështetur nga marrëveshjet e kombinuara PRGF (Fondi i Reduktimit të Varfërisë dhe Rritjes Ekonomike) dhe EFF (Fondi i Zgjeruar) do të përfundojë në janar të 2009-ës, duke supozuar se rishikimi i gjashtë dhe i fundit do të përfundohet në kohë. Programi aktual është i gjashti që Shqipëria ka patur me FMN-në. Që në fillim të tij, pritej që ky do të ishte programi i fundit PRGF me Shqipërinë, i cili është konceptuar për vendet më të varfëra.

“Nëse autoritetet shqiptare janë të interesuara, FMN-ja është gati për diskutuar një program të ri. Ky program do të përqëndrohet në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, por do të përmbante më pak kushte për reformat strukturore dhe ndoshta akses për financime nga FMN. Kjo mund të ketë formën e një marrëveshjeje të rregullt ose paraprake të gatishmërisë (Stand-By Arrangement).

“Kërkesa për një marrëveshje të re vjen nga autoritetet e një vendi anëtar të FMN-së. Kjo mund të diskutohet më tej me qeverinë gjatë mbledhjeve vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore programuar që të zhvillohen në Uashington në mes të tetorit, si dhe gjatë misionit të fundit të rishikimit të FMN-së që pritet të vizitojë Tiranën në fillim të nëntorit.

“Së fundmi, Shqipëria do të vazhdojë të ketë askes në asistencën teknike të FMN-së dhe do të ndërmarrë konsultimet vjetore të Artikullit IV në përfundim të programit, siç veprohet me të gjitha vendet anëtare të FMN-së.”